# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2025 – Numri: 57

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E martë, 25 mars 2025**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Kuvendit nr. 25/2025, datë 13.3.2025 | Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian.................................................................................. | 6429 |
| Vendim i Kuvendit nr. 26/2025, datë 13.3.2025 | Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit”......................... | 6429 |
| Vendim i Kuvendit nr. 28/2025, datë 17.3.2025 | Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 127/2018, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave”........................................................... | 6429 |
| Vendim i Kuvendit nr. 30/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zonjës Laureta Roshi anëtare të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri. .......... | 6435 |
| Vendim i Kuvendit nr. 31/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zonjës Etleva Smaçi anëtare të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri............ | 6435 |
| Vendim i Kuvendit nr. 32/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Mentor Beqa anëtar të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri............ | 6435 |
| Vendim i Kuvendit nr. 33/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Vasil Tole anëtar të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri............ | 6436 |
| Vendim i Kuvendit nr. 34/2025, datë 17.3.2025 | Për moszgjedhjen e zotit Marenglen Kasmi anëtar të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.......................................................................................... | 6436 |
| Vendim i Kuvendit nr. 35/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zonjës Alma Mirakaj anëtare të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri............ | 6436 |



Adresa: Rruga “Nikolla Jorga”, Tiranë: Tel./fax +355 4 24 27 004   Tel. +355 4 24 27 006

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Kuvendit nr. 36/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Simon Mirakaj anëtar të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri............ | 6437 |
| Vendim i Kuvendit nr. 37/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Niuton Mulleti anëtar të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri............ | 6437 |
| Vendim i Kuvendit nr. 38/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Enio Civici anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6437 |
| Vendim i Kuvendit nr. 39/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Pano Xhixho anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6438 |
| Vendim i Kuvendit nr. 40/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Alket Braho anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6438 |
| Vendim i Kuvendit nr. 41/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zonjës Zamira Kita anëtare të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6438 |
| Vendim i Kuvendit nr. 42/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Lorenc Vangjeli anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6439 |
| Vendim i Kuvendit nr. 43/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Bujar Kapexhiu anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6439 |
| Vendim i Kuvendit nr. 44/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Osman Mula anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6439 |
| Vendim i Kuvendit nr. 45/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Petrit Beci anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6440 |
| Vendim i Kuvendit nr. 46/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zonjës Rajmonda Bulku anëtare të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar................................................................ | 6440 |
| Vendim i Kuvendit nr. 47/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Robert Budina anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6440 |
| Vendim i Kuvendit nr. 48/2025, datë 17.3.2025 | Për moszgjedhjen e zotit Helidon Haliti kryetar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar................................................................. | 6441 |
| Vendim i Kuvendit nr. 49/2025, datë 17.3.2025 | Për zgjedhjen e zotit Fatjon Hoxhalli kryetar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.................................................................... | 6441 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 20.3.2025 | Për miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim të *Abu Dhabi*-t, lidhur me grantin e Emirateve të Bashkuara Arabe për "Mbështetjen për buxhetin e përgjithshëm mbi përpjekjet për zhvillim" ........................................................................................ | 6441 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 20.3.2025 | Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA), "Për programin e zhvillimit të mjedisit" .................................. | 6445 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 257, datë 17.3.2025 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Polonisë................................................ | 6447 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 8021, datë 16.12.2024 | Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Albert Xheleshi............................. | 6450 |
| Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 35 (301), datë 30.1.2025 | Për heqjen e plotë të zotësisë për të vepruar të shtetases Meivis Cani.. | 6450 |

**VENDIM**
**Nr. 25/2025**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN, SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, nenit 24 dhe nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian zgjatet për një periudhë katërmujore, nga data 30 mars 2025 deri në datën 30 korrik 2025.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 13.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 26/2025**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR "PËR TË KOORDINUAR DHE MBIKËQYRUR TË GJITHA VEPRIMET INSTITUCIONALE PËR TË LUFTUAR DEZINFORMIMIN DHE FORMAT E TJERA TË NDËRHYRJES SË HUAJ NË PROCESET DEMOKRATIKE TË VENDIT"**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit" zgjatet deri në përfundim të Legjislaturës X.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 13.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 28/2025**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 127/2018, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE"**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të

pavarura, të krijuara me ligj", i ndryshuar, nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 17/2018, "Për statistikat zyrtare", si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Institutit të Statistikave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, të vendimit të Kuvendit nr. 127/2018, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave" ndryshohen sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

LIDHJA *1*

**ORGANIKA E INSTITUTIT TË STATISTIKAVE**

| | **POZICIONI** | **NUMRI** | **KATEGORIA** |
|---|---|---|---|
| **I** | **DREJTOR I PËRGJITHSHËM** | **1** | |
| | SEKRETAR I PËRGJITHSHËM | 1 | I-2 |
| **II** | **SEKTORI I KOORDINIMIT PRANË DP** | **(2)** | |
| | SPECIALIST | 1 | IV-1 |
| | SEKRETAR | 1 | |
| **III** | **DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE** | **(5)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-2 |
| **IV** | **SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| **V** | **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRODHIMIT STATISTIKOR** | | |
| | DREJTOR I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME | 1 | I-4 |
| **V/1** | **DREJTORIA E LLOGARIVE KOMBËTARE** | **(25)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I LLOGARIVE KOMBËTARE VJETORE DHE RAJONALE** | **(5)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 4 | IV-1 |
| | **SEKTORI I LLOGARIVE TË SEKTORËVE INSTITUCIONAL** | **(6)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 5 | IV-1 |
| | **SEKTORI SINTEZË I LLOGARIVE KOMBËTARE** | **(5)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 4 | IV-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË QEVERISË** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| | **SEKTORI I LLOGARIVE KOMBËTARE 3-MUJORE** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| **V/2** | **DREJTORIA E STATISTIKAVE EKONOMIKE** | **(20)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE VJETORE TË NDËRMARRJEVE** | **(6)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 5 | IV-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE AFATSHKURTRA DHE TURIZMIT PRANË NDËRMARRJEVE** | **(7)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | SPECIALIST | 6 | IV-1 |
| | **SEKTORI I REGJISTRIT STATISTIKOR TË NDËRMARRJEVE** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË KËRKIM-ZHVILLIMIT, INOVACIONIT, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| **V/3** | **DREJTORIA E POPULLSISË DHE STATISTIKAVE SOCIALE** | **(15)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË POPULLSISË DHE CENS** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË KONSUMIT TË FAMILJEVE DHE TIK** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| | **SEKTORI I NIVELIT TË JETESËS** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË TURIZMIT PRANË FAMILJEVE** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| **V/4** | **DREJTORIA E STATISTIKAVE TË PUNËSIMIT DHE ANALIZAVE NDËRSEKTORIALE** | **(12)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË TREGUT TË PUNËS** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| | **SEKTORI I ANALIZAVE NDËRSEKTORIALE (PËRFSHIRË ÇËSHTJET GJINORE, ARSIM, KULTURË, DREJTËSI)** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| **V/5** | **DREJTORIA E STATISTIKAVE TË BUJQËSISË DHE MJEDISIT** | **(15)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË TOKËS DHE PRODHIMIT BIMOR** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË BLEGTORISË DHE PESHKIMIT** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I LLOGARIVE EKONOMIKE NË BUJQËSI DHE MJEDIS** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST PËR INDEKSIN E ÇMIMEVE | 3 | IV-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË MJEDISIT DHE PYJEVE** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| **V/6** | **DREJTORIA E STATISTIKAVE SEKTORIALE** | **(13)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I TREGTISË SË JASHTME** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT DHE BANESAVE** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I ÇMIMEVE (BUJQËSI, INDUSTRI, SHËRBIME)** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I STATISTIKAVE TË ENERGJISË DHE TRANSPORTIT** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| **VI** | **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MBLEDHJES SË TË DHËNAVE** | | |
| | DREJTOR I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME | 1 | I-4 |
| **VI/1** | **DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT** | **(32)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I MENAXHIMIT TË BAZAVE TË TË DHËNAVE DHE AKSESIT NË MIKRODATA** | **(7)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 6 | IV-1 |
| | **SEKTORI I CILËSISË DHE METADATAVE** | **(5)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 4 | IV-1 |
| | **SEKTORI I ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE** | **(6)** | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 5 | IV-1 |
| | **SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË SISTEMEVE TI DHE SIGURISË KIBERNETIKE** | **(6)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 5 | IV-1 |
| | **SEKTORI I METODOLOGJISË** | **(7)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 6 | IV-1 |
| **VI/2** | **DREJTORIA E GJEOINFORMACIONIT, MBLEDHJES SË TË DHËNAVE DHE STATISTIKAVE RAJONALE** | (66) | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I GJEOINFORMACIONIT DHE REGJISTRIT STATISTIKOR TË NDËRTESAVE DHE BANESAVE** | **(5)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| | SPECIALIST | 1 | IV-2 |
| | **SEKTORI I KOORDINIMIT DHE MBLEDHJES SË TË DHËNAVE** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| | **SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MONITORIMIT TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE** | **(7)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 6 | IV-1 |
| | **ZYRAT RAJONALE** | **(49)** | |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE TIRANË | **4** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE ELBASAN | **4** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE KORÇË | **6** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 5 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE SHKODËR | **5** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 4 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE LEZHË | **4** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE DIBËR | **3** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE DURRËS | **4** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE VLORË | **5** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 4 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE FIER | **6** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 5 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE KUKËS | **3** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE BERAT | **3** | |
| | PËRGJEGJËS ZYRE | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-3 |
| | ZYRA RAJONALE STATISTIKORE GJIROKASTËR | **2** | |
| | PËRGJEGJËS | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST | 1 | IV-3 |
| **VII** | **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOORDINIMIT, PROJEKTEVE DHE KOMUNIKIMIT** | | |
| | DREJTOR I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME | 1 | I-4 |
| **VII/1** | **DREJTORIA E KOORDINIMIT TË SKS, PËRAFRIMIT DHE PROJEKTEVE** | (11) | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I KOORDINIMIT DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK (PSZ-së)** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I PËRAFRIMIT TË LEGJISLACIONIT DHE ÇËSHTJEVE LIGJORE** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I PROJEKTEVE** | **(4)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 3 | IV-1 |
| **VII/2** | **DREJTORIA KOMUNIKIMIT DHE PUBLIKIMEVE** | (11) | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I PUBLIKIMEVE** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | BIBLIOTEKAR | **(1)** | |
| | **SEKTORI I ANALIZËS SË WEB DHE DIZAJNIT** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| **VIII** | **DREJTORIA E FINANCËS, PROKURIMEVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE** | **(20)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-1 |
| | **SEKTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT** | **(5)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST BUXHETI | 1 | IV-1 |
| | SPECIALIST FINANCE | 2 | IV-1 |
| | SPECIALIST PËR FINANCIMET E HUAJA | 1 | IV-1 |
| | **SEKTORI I PROKURIMEVE** | **(3)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-1 |
| | SPECIALIST | 2 | IV-1 |
| | **SEKTORI I SHËRBIMEVE** | **(11)** | |
| | PËRGJEGJËS SEKTORI | 1 | III-2 |
| | SPECIALIST ARKIVIST | 1 | IV-2 |
| | SPECIALIST PROTOKOLLIST | 1 | IV-2 |
| | TEKNIK/MAGAZINIER | 1 | |
| | NËPUNËS INFORMACIONI | 1 | |
| | SHOFER | 3 | |
| | PASTRUES/SANITAR | 2 | |
| | TEKNIK MIRËMBAJTJE | 1 | |
| **IX** | **DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE** | **(5)** | |
| | DREJTOR | 1 | II-2 |
| | SPECIALIST | 4 | IV-1 |
| | **TOTALI** | **260** | |

LIDHJA 2



**VENDIM**
**Nr. 30/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS LAURETA ROSHI ANËTARE TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim nga shoqëria civile,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Laureta Roshi zgjidhet anëtare e Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 31/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ETLEVA SMAÇI ANËTARE TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Rektorëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Etleva Smaçi zgjidhet anëtare e Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 32/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT MENTOR BEQA ANËTAR TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Rektorëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Mentor Beqa zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 33/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT VASIL TOLE ANËTAR TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 8, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Akademisë së Shkencave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Vasil Tole zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 34/2025**

**PËR MOSZGJEDHJEN E ZOTIT MARENGLEN KASMI ANËTAR TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 8, të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Akademisë së Shkencave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Moszgjedhjen e zotit Marenglen Kasmi anëtar të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 35/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ALMA MIRAKAJ ANËTARE TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Alma Mirakaj zgjidhet anëtare e Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 36/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT SIMON MIRAKAJ ANËTAR TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Simon Mirakaj zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 37/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT NIUTON MULLETI ANËTAR TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Institutit të Integrimit të ish të Përndjekurve Politikë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Niuton Mulleti zgjidhet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 38/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ENIO CIVICI ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Enio Civici zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 39/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT PANO XHIXHO ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Pano Xhixho zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 40/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ALKET BRAHO ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Alket Braho zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 41/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ZAMIRA KITA ANËTARE TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Zamira Kita zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 42/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT LORENC VANGJELI ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Lorenc Vangjeli zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 43/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT BUJAR KAPEXHIU ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Bujar Kapexhiu zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 44/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT OSMAN MULA ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Osman Mula zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 45/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT PETRIT BECI ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Petrit Beci zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 46/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS RAJMONDA BULKU ANËTARE TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Rajmonda Bulku zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 47/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ROBERT BUDINA ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Robert Budina zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 48/2025**

**PËR MOSZGJEDHJEN E ZOTIT HELIDON HALITI KRYETAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 95 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Moszgjedhjen e zotit Helidon Halitit si kryetar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 49/2025**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT FATJON HOXHALLI KRYETAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 95 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Fatjon Hoxhalli zgjidhet kryetar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
**Elisa Spiropali**

Miratuar në datën 17.3.2025.

**VENDIM**
**Nr. 178, datë 20.3.2025**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT PËR ZHVILLIM TË *ABU DHABI*-t, LIDHUR ME GRANTIN E EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE PËR "MBËSHTETJEN PËR BUXHETIN E PËRGJITHSHËM MBI PËRPJEKJET PËR ZHVILLIM"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim të *Abu Dhabi*-t, lidhur me grantin e Emirateve të Bashkuara Arabe për "Mbështetjen për buxhetin e përgjithshëm mbi përpjekjet për zhvillim", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

*Logo*
ADFD
FONDI PËR ZHVILLIM I ABU DABIT
MARRËVESHJE GRANTI NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FONDIT PËR ZHVILLIM TË ABU DABIT
(ADFD)
Janar 2025

Lidhur me:
**Grantin e Emirateve të Bashkuara Arabe për Mbështetjen për Buxhetin e Përgjithshëm mbi Përpjekjet për Zhvillim**

**Indeksi**

- Preambula
- E gjithë Marrëveshja e Grantit dhe anekset
- Përkufizimet
- Granti, të ardhurat dhe përdorimi
- Tërheqja nga Granti
- Teprica e Grantit dhe ndërprerja ose pezullimi
- Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Grantit
- Të ndryshme
- Vizibiliteti dhe informacioni
- Konfidencialiteti
- Vlefshmëria dhe ndërprerja
- Zgjedhja e adresave

**Marrëveshje Granti**

**Sot e mërkurë, datë 15.1.2025, dhe në Abu Dhabi.**

Është lidhur kjo Marrëveshje nga dhe ndërmjet,

**Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë** e përfaqësuar nga **SH.T. Petrit Malaj ministër i Financave** (në vijim e referuar si "**Qeveria, Përfituesi i Shtetit**"), dhe

**Fondit për Zhvillim të Abu Dhabit**, i përfaqësuar nga **SH.T. Mohammed Saif Al Suwaidi**, drejtor i përgjithshëm (në vijim i referuar si **ADFD**-ja).

**(Preambulë)**

a) Në njohje të lidhjeve të ngushta historike ndërmjet Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Republikës së Shqipërisë, dhe në vijim të udhëzimeve të Lartësisë së Tij Sheikh Mohammed Bin Zayed Al Nahyan, President i EBA-së, për alokimin e një shume prej (20,000,000) $ (njëzet milionë dollarë amerikanë) si grant nga EBA-ja, për të ndihmuar në Mbështetjen për Buxhetin e Përgjithshëm mbi përpjekjet për zhvillim.

b) Duke pasur parasysh se Qeveria e EBA-së ka caktuar Fondin për Zhvillim të Abu Dhabit (ADFD), që të menaxhojë grantin në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Granti dhe rregullat, rregulloret dhe procedurat e zbatueshme të ADFD-së;

**Tani dhe në vijim**, palët kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1
**E gjithë Marrëveshja e Grantit dhe anekset**

Preambula do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje Granti.

Neni 2
**Përkufizimet**

Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet që u janë dhënë atyre:

a) **ADFD**-ja nënkupton Fondin për Zhvillim të Abu Dhabit;

b) **Qeveri** nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si "**Qeveria**");

c) **Ditë pune** nënkupton ditën kur bankat dhe subjektet qeveritare janë të hapura për biznes të përgjithshëm në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe te Përfituesi.

Neni 3
**Të ardhurat nga Granti dhe përdorimi**

1. Granti do të përdoret për qëllimet e synuara, përveç kur ADFD-ja miraton ndryshe paraprakisht.
2. Të ardhurat e grantit do të përdoren për mbështetjen për buxhetin e përgjithshëm mbi përpjekjet për zhvillim, siç specifikohet në përputhje me skedulin 1.
3. Dirhami i Emirateve të Bashkuara Arabe ose dollari amerikan, siç konsiderohet llogaria e valutës, do të jenë shumat për grantin dhe mjetet e pagesës në gjithçka që lidhet me grantin. Megjithatë, ADFD-ja mund të kryejë pagesa në çdo valutë tjetër që nevojitet për Projektin, ku ekuivalenti në Dirham të Emirateve të Bashkuara Arabe ose dollarë amerikanë do të konsiderohet i tërhequr nga gjendja e grantit në kursin e këmbimit mbizotërues të tregut.
4. Qeveria ka të drejtën të marrë të gjitha vendimet në lidhje me zbatimin e grantit dhe

autoritetet të menaxhojnë grantin për të arritur qëllimet e tij të synuara.

5. ADFD-ja do të përfitojë 2% të shumës totale të grantit si tarifa administrimi dhe menaxhimi.

6. Qeveria merr përsipër të zbatojë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet dhe legjislacionin në fuqi në lidhje me parandalimin e mitëmarrjes, korrupsionit, financimit të terrorizmit, pastrimit të parave dhe mashtrimit. Gjithashtu, ajo merr përsipër të njoftojë menjëherë ADFD-në në rast të ndonjë shkeljeje të këtyre marrëveshjeve dhe ligjeve dhe masave të marra për adresimin e këtyre shkeljeve, nëse ka ndonjë.

Neni 4
**Tërheqja nga Granti**

1. Shuma e grantit nuk mund të përdoret për të mbuluar shpenzimet e bëra përpara datës së kësaj Marrëveshjeje Granti, përveç nëse është rënë dakord dhe miratuar paraprakisht nga ADFD-ja.

2. ADFD-ja ka të drejtën të mbajë dhe të krijojë tërheqje nga granti nëse përfituesi nuk përmbush ndonjë prej detyrimeve të tij ndaj ADFD-së në bazë të kësaj marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të zbatuar aktualisht.

Neni 5
**Teprica e Grantit dhe ndërprerja ose pezullimi**

1. ADFD-ja ka të drejtën në çdo kohë, pas konsultimit me Qeverinë, të pezullojë përkohësisht tërheqjen nga granti. ADFD-ja, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Granti dhe pas konsultimit me Qeverinë, mund të anulojë alokimin e ndonjë gjendjeje të patërhequr në rastet e forcës madhore, me kusht që gjendja në fjalë e anuluar të ripërdoret në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.

2. Nëse ADFD-së i bëhet e qartë se ka ndonjë tepricë, gjendje të papërdorur ose të panevojshme të alokuar më parë për qëllime ekzekutimi për ndonjë projekt të rënë dakord, ADFD-ja mund t'i dërgojë një njoftim Qeverisë dhe të vazhdojë me anulimin e tepricës.

3. Pa cenuar paragrafin e mësipërm, ADFD-ja dhe Qeveria angazhohen të konsultohen dhe të dakordësohen në lidhje me përdorimin e çdo teprice nga granti, deri në datën e anulimit, siç parashikohet në dy paragrafët e mësipërm. Teprica mund të rialokohet për çdo qëllim të marrëveshjes së grantit.

4. Në rast të shkeljes së rëndë të Marrëveshjes, ADFD-ja mund ta ndërpresë Marrëveshjen me efekt të menjëhershëm.

5. Në rast të ndërprerjes nga ADFD-ja, ndërprerja nuk do të zbatohet për fondet e kryera në mënyrë të parevokueshme në mirëbesim nga Qeveria ndaj palëve të treta përpara datës së njoftimit me shkrim të ndërprerjes, me kusht që angazhimet të jenë bërë në përputhje me këtë Marrëveshje.

6. Çdo ndërprerje do të bëhet me njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 6
**Zbatueshmëria e Marrëveshjes së Grantit**

1. Të drejtat dhe detyrimet e ADFD-së dhe Qeverisë, siç specifikohet në këtë Marrëveshje Granti, do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me dispozitat e saj, pavarësisht nga ndonjë ligj tjetër vendas që parashikon ndryshe. Asnjë palë, nuk do të kundërshtojë, në asnjë rast, ndonjë nen të pavlefshëm ose të paefektshëm në këtë Marrëveshje Granti, për çfarëdo arsye.

2. Të dyja palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zgjidhur me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje ose mospajtim në lidhje me këtë Marrëveshje Granti.

Neni 7
**Të ndryshme**

1. Noterizimi, dokumentacioni dhe dhënia e kësaj Marrëveshje Granti nuk do të jenë subjekt i asnjë takse, tarife ose shpenzimi të vendosur nga ligjet në fuqi të vendit. Po ashtu, të gjitha punët e financuara nga granti do të jenë në kushte të barabarta për të siguruar të njëjtin lehtësim.

2. Të gjitha kërkesat ose njoftimet nga secila palë ndaj tjetrës në lidhje me këtë Marrëveshje Granti, ose në lidhje me zbatimin e saj, duhet të jenë me shkrim dhe brenda një dite pune. Çdo kërkesë ose njoftim do të konsiderohet i dorëzuar dhe dërguar në mënyrën e duhur kur dorëzohet dorazi, me faks, me postë të zakonshme, e-mail, ose në adresën e treguar në këtë Marrëveshje Granti ose në çdo adresë tjetër të dhënë me njoftim palës tjetër.

3. Qeveria do t'i japë ADFD-së dokumente zyrtare për përfaqësuesin/t zyrtar dhe kompetencat e tyre për ata që veprojnë në emër të Qeverisë, për të ndërmarrë çdo veprim ose për të nënshkruar çdo dokument në përputhje me këtë Marrëveshje Granti, së bashku me nënshkrimin model të tyre.

4. Qeveria do të përfaqësohet nga ministri i Financave (ministri i autorizuar) për ndërmarrjen e çdo veprimi në lidhje me këtë Marrëveshje Granti, përfshirë nënshkrimin e çdo dokumenti ose aplikimi për tërheqje nga granti. Këto autorizime mund t'i delegohen çdo personi që vepron në emër të tij në bazë të një autorizimi zyrtar me shkrim nga ministri i Financave (ministri i autorizuar) ose Kryeministri.

5. Ndryshimet ose shtesat në këtë Marrëveshje Granti do të bëhen me shkrim dhe miratohen nga përfaqësuesi ligjor i Qeverisë dhe ADFD-së ose nga çdo person tjetër i autorizuar zyrtarisht me shkrim në kohën e duhur.

Neni 8

**Vizibiliteti dhe informacioni**

1. Në referimin e aktiviteteve, të financuara plotësisht ose pjesërisht në përputhje me këtë Marrëveshje Granti, Përfituesi do të publikojë gjithmonë të gjitha aktivitetet e financuara nëpërmjet grantit. Publikimi duhet të tregojë se ADFD-ja, me mbështetjen e Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, janë financuesit e këtyre projekteve. Logoja e ADFD-së duhet të përdoret në të gjithë mbulimin me publikim dhe media dhe duhet të jetë e gjitha në përputhje me procedurat e ADFD-së dhe me miratimin e tyre paraprak.

2. Qeveria duhet të tregojë kujdesin e duhur që të ruajë reputacionin dhe pozicionin e ADFD-së dhe Emirateve të Bashkuara Arabe.

Neni 9

**Konfidencialiteti**

1. Të dyja Palët bien dakord dhe marrin përsipër të ruajnë të gjithë informacionin në lidhje me këtë Marrëveshje Granti. Gjithashtu, të dyja Palët bien dakord të mos i zbulojnë informacione konfidenciale asnjë personi ose subjekti pa pëlqimin e palës tjetër, përveç në masën që kërkohet t'i zbulohet ndonjë autoriteti në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të të dyja vendeve.

2. Asnjëra palë, gjatë afatit të kësaj Marrëveshjeje Granti ose për pesë vjet pas skadimit ose përfundimit të saj: nuk do të kopjojë, publikojë, shpërndajë ose zbulojë ndonjë prej informacioneve Konfidenciale ndonjë pale të tretë; ose nuk do të përdorë informacionin konfidencial për ndonjë qëllim tjetër përveç për transaksionet dhe bashkëpunimin e parashikuar nga kjo Marrëveshje Granti. Palët do të ndërmarrin të gjitha mjetet për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit nga çdo prodhim, publikim, shpërndarje ose zbulim të paautorizuar.

Neni 10

**Vlefshmëria dhe ndërprerja**

1. Marrëveshja e parashikuar siç përfshihet në këtë Marrëveshje Granti bëhet e vlefshme dhe efektive pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar sipas rregullave për të dyja palët.

2. Pa cenuar nenin 6, kjo Marrëveshje Granti mbetet e vlefshme dhe efektive derisa secila palë të përmbushë detyrimet e saj në bazë të dispozitave të saj.

Neni 11

**Marrëveshja e Grantit zgjedhja e adresave**

**Adresa e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë:**
**SH.T. Petrit Malaj**
**Ministër i Financave**
Tel.: +355694248906
E-mail: info@finance.gov.al
**Adresa e Fondit:**
**Fondi për Zhvillim i Abu Dhabit**
P.O. Box 814, Abu Dabi
Tel: 9712-6677100
Faks: 9712-6677070
E-mail: operation@adfd.ae

Kjo Marrëveshje Granti është nënshkruar nga të dyja palët, në datën e specifikuar më sipër, nga personi i autorizuar në mënyrë të rregullt në Abu Dhabi, në dy kopje origjinale, ku të gjitha tekstet do të konsiderohen si dokument origjinal.

| | |
|---|---|
| PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË<br>**SH.T. Petrit Malaj**<br>MINISTËR I FINANCAVE | PËR FONDIN PËR ZHVILLIM I ABU DABI-t<br>**Nënshkrimi** |

SHTOJCA NR. 1
OBJEKTIVAT E GRANTIT

(Granti synon të mbështesë ekonominë e Republikës së Shqipërisë, duke mbështetur buxhetin e përgjithshëm për mbështetjen e përpjekjeve për zhvillim.)

**Përshkrimi i Grantit**

**Mbështetje për buxhetin e përgjithshëm mbi përpjekjet për zhvillim**

| Zëri | Komponentet e Projektit | Shuma e financimit ($ dollarë amerikanë) | Shuma e financimit (AED dirham të Emirateve të Bashkuara Arabe) | Financimi % vlera |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mbështetja për buxhetin | 19,600,000 | 71,990,800 | %100 |
| 2 | Tarifa administrative | 400,000 | 1,469,200 | %100 |
| | **Total i** | **20,000,000** | **73,460,000** | |

**VENDIM**
**Nr. 179, datë 20.3.2025**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR DHE ZHVILLIM (SIDA), "PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT TË MJEDISIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA), "Për programin e zhvillimit të mjedisit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

MARRËVESHJE NDRYSHUESE E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM (SIDA) MBI PROGRAMIN PËR MBËSHTETJEN E MJEDISIT

*Numri i Kontributit të Sida-s 12331*
*Marrëveshje ndryshuese nr. 1*
***

Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida) dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, kanë lidhur një Marrëveshje, më 4 qershor 2021 mbi Programin për Mbështetjen e Mjedisit. Palët tashmë kanë vendosur të ndryshojnë Marrëveshjen siç përcaktohet në nenet e mëposhtme.

Kushtet e pandryshuara në Marrëveshje do të vijojnë të pandryshuara.

**Ndryshimet e Marrëveshjes**

Nenet 1, 7, 19 dhe 20 të Marrëveshjes së lartpërmendur do të ndryshohen si më poshtë.

**Neni 1 – Fushëveprimi dhe historiku**

Në vend të:

1.1 Në vitin 2006, Shqipëria dhe Suedia nënshkruan një Marrëveshje për kushtet e përgjithshme për bashkëpunimin zhvillimor. Suedia tashmë ka vendosur të japë një grant që do të përdoret ekskluzivisht për zbatimin e "Programit për Mbështetjen e Mjedisit", me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Programi do të zbatohet për një periudhë 36-mujore, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Aktualisht do të bëhet:

1.1 Në vitin 2006, Shqipëria dhe Suedia nënshkruan një Marrëveshje për termat dhe kushtet e përgjithshme për bashkëpunimin zhvillimor. Suedia tashmë ka vendosur të japë një grant që do të përdoret ekskluzivisht për zbatimin e "Programit për Mbështetjen e Mjedisit", me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Projekti do të zbatohet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe deri më 31tetor 2027.

**Neni 7 – Raportimi financiar**

Në vend të:

7.1 Përfituesi, nëpërmjet GDFC-së, do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Suedisë pasqyrat financiare gjashtëmujore dhe raporte financiare për Programin jo më vonë se datat 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti. Raporti i parë financiar që mbulon vitin 2021, do të dorëzohet jo më vonë se data 31 mars 2022.

7.2 Raporti financiar gjashtëmujor do të mbulojë periudhat nga 1 janari deri më 30 qershor dhe nga 1 korriku deri më 31 dhjetor. Pasqyrat financiare/raportet financiare do të përfshijnë të ardhurat dhe kostot aktuale me një krahasim me buxhetin e miratuar për periudhën raportuese dhe do të tregojnë financimin nga Suedia, në formë dhe detaje që lejojnë identifikimin e disbursimeve për projektin e rënë dakord. Buxheti do të rishikohet gjatë fazës fillestare dhe do të miratohet nga Suedia. Pasqyrat financiare/raportet financiare do të nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Financimit dhe Kontraktimit, GDFC.

7.3 Pasqyrat financiare gjashtëmujore dhe raportet financiare do të përfshijnë informacion mbi shumën e marrë, si në monedhën e transferimit ashtu edhe shumën në monedhën vendëse, kursin e këmbimit dhe informacionin për datën kur shuma është kredituar.

7.4 Raporti do të përfshijë, gjithashtu, informacion mbi shpenzimet totale, të ndara në përputhje me titujt e buxhetit të rënë dakord, për periudhën raportuese, si dhe shumat e akumuluara për të gjithë periudhën e Programit.

Aktualisht do të bëhet:

7.1 Përfituesi, nëpërmjet GDFC-së, do të përgatisë dhe dorëzojë në Suedi raportet financiare vjetore jo më vonë se data 31 mars për çdo vit. Përfituesi gjithashtu do të përgatisë dhe dorëzojë në Suedi raporte financiare gjashtëmujore të thjeshtuara të paaudituara jo më vonë se data 30 shtator për çdo vit që mbulon periudhën nga 1 janari deri më 30 qershor.

7.2 Raportet vjetore financiare do të përfshijnë të ardhurat dhe kostot aktuale me një krahasim me buxhetin e miratuar për periudhën raportuese dhe do të tregojnë financimin nga Suedia, në formë dhe detaje që lejojnë identifikimin e disbursimeve për projektin e rënë dakord. Raporti financiar vjetor do të përfshijë gjithashtu informacion mbi të ardhurat dhe kostot totale që nga fillimi i periudhës së zbatimit, të ndara në përputhje me titujt e buxhetit të rënë dakord. Raportet vjetore financiare do të nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Financimit dhe Kontraktimit, GDFC.

7.3 Raportet financiare vjetore duhet të përfshijnë informacion mbi shumën e marrë, si në monedhën e transferimit ashtu edhe shumën në monedhën vendëse, kursin e këmbimit dhe informacionin për datën kur shuma është kredituar.

7.4 Raporti financiar i thjeshtuar i paaudituar për periudhën vjetore 1 janar deri më 30 qershor, do të përfshijë informacion mbi të ardhurat totale dhe kostot totale që nga fillimi i periudhës së zbatimit, në krahasim me buxhetin total të Programit.

**Neni 19 – Përfundimi**

Në vend të:

19.1 Kjo Marrëveshje do të mbetet e vlefshme deri në 42 muaj pas hyrjes në fuqi, përveç rasteve kur ndërpritet më herët me njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara nga secila palë.

Aktualisht do të bëhet:

19.1 Kjo Marrëveshje do të mbetet e vlefshme deri më 30 qershor 2028, përveç rasteve kur ndërpritet më herët me njoftim me shkrim gjashtë muaj nga secila palë.

**Neni 20 – Periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes**

Në vend të:

20.1 Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas komunikimit me shkrim të Marrësit për përfundimin e procedurave të saj të brendshme dhe do të mbetet e vlefshme deri në 42 muaj pas fillimit të saj, përveç rasteve kur ndërpritet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose deri në kthimin e fondeve të papërdorura për Sida-n dhe përmbushjen e kërkesave të raportimit të kësaj Marrëveshjeje, kohë në të cilën kjo Marrëveshje skadon.

Aktualisht do të bëhet:

20.1 Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit me shkrim të Marrësit për përfundimin e procedurave të saj të brendshme dhe do të mbetet e vlefshme deri më 30 qershor 2028, përveç rasteve kur ndërpritet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose deri në kthimin e çdo fondi të papërdorur për Sida-n dhe përmbushjen e kërkesave të raportimit të kësaj Marrëveshjeje, kohë në të cilën kjo Marrëveshje skadon.

**Hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese**

Kjo Marrëveshje Ndryshuese do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit me shkrim të Marrësit në lidhje me përfundimin e procedurave të tij të brendshme ligjore.

Bërë në dy origjinale, secili në gjuhët shqipe dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëlloj të barasvlershme.

| | |
|---|---|
| Tiranë, 3.12.2024 | Tiranë, 11.12.2024 |
| Vendi dhe data<br>Në emër të Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), të përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Tiranë | Vendi dhe data<br>Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Mimistria e Financave |
| Nënshkrimi<br>*/Nënshkrimi/* | Nënshkrimi<br>**Petrit Malaj** |
| **Erik Illes**, përgjegjës i Departamentit të Bashkëpunimit | (Emri /Mbiemri /Titulli) |

## URDHËR
## Nr. 257, datë 17.3.2025

## PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të $F_0$ prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

| Ndarja administrative e nivelit të parë | Ndarja administrative e nivelit të dytë | Ndarja administrative e nivelit të tretë |
|---|---|---|
| Dolnośląskie* | | |
| Lubelskie* | | |
| Lubuskie* | | |
| Małopolskie* | | |
| Mazowieckie* | | |
| Opolskie* | | |
| Podkarpackie* | | |
| Podlaskie* | | |
| Kujawsko-Pomorskie | Grudziądz | Łasin* |
| Warmińsko-Mazurskie* | | |
| Wielkopolskie* | | |
| Zachodniopomorskie* | | |
| Świętokrzyskie* | | |

*Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Polonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit;

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demostron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të

Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 722, datë 18.9.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Polonisë", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Anila Denaj**

**VENDIM**
*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 8021, datë 16.12.2024 vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Albert Xheleshi, me atësi Sinan dhe amësi Nadire, i datëlindjes 28.6.1984, lindur në Zogaj Dibër dhe banues në Larushk Fushë-Krujë, duke përcaktuar si datë zhdukjeje datën 15.12.2016, si dhe caktimin si kujdestare të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të tij shtetasen Shkurte Xheleshi.

**VENDIM**
*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 35 (301), datë 30.1.2025, vendosi heqjen e plotë të zotësisë për të vepruar të shtetases Meivis Cani, me atësi Avni dhe amësi Etleva, e datëlindjes 13.3.1990, lindur në Shkodër, si dhe caktimin si kujdestare të saj të ëmën, shtetasen Etleva Cani.

| | Formati 61x86/8 |
|---|---|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/03/25 15:42:46 +02'00'
49c83cd0106e4fa1956ae0dd3dea5f19202503251 5423844031

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë*
*të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*